



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 23.15.1-2018-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR ZYRËN SË RREGULLATORIT TË ENERGJISË
PËR VITIN FINANCIAR TË PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018

Prishtinë, maj 2019

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Emine Fazliu, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Refiqe Morina (udhëheqëse ekipi) dhe Enver Ramadani (anëtar ekipi), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Astrit Bllaca.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	10
4 Qeverisja e mirë.....	14
5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	15
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	17
Shtojca II: Letërkonfirmimi.....	20

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për vitin 2018, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2018 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 22.01.2019.

Auditimi është fokusuar në:



Niveli i angazhimit për të kryer auditimin është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2018 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Më gjerësisht shih pjesën 2.1 të këtij raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Konkluzionet dhe rekomandimi



Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2018

Kryesuesi I bordit është pajtuar me gjetjen dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj rekomandimin e dhënë.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të ZRRE-së gjatë procesit të auditimit.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase.
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRE), nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përmbledhje të detajuar për çdo fushë të rishikimit.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm

Auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese dhe cilësinë e saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV, përfshirë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar

Ne kemi audituar PFV-të e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV

Kryesuesi i Bordit dhe Zyrtari Kryesor Financiar janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, dhe për kontrollet e brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryesuesi i Bordit është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të ZRRE-së.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave të SNISA-ve, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbuloj çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Nga ZRRE kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullat Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK);
- Planin final të prokurimit; dhe
- Raportet për obligimet e papaguara.

Lidhur me PFV-të, dhe kërkesat tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi ndonjë çështje për të ngritur.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, konsiderohet e saktë.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Nuk kemi rekomandime lidhur me PFV-të.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, burimet njerëzore si dhe pasuritë e detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

ZRRE ka kontrolle të mira në raport me obligimet statusore të saj. Menaxhimi financiar dhe kontrolli efektiv kanë dëshmuar proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera të kontrollit. Megjithatë, sfida për institucionin edhe më tutje mbetet menaxhimi i pasurisë jo kapitale.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Burimet e Fondeve:	784,328	690,267	648,075	592,128	678,711
Granti i Qeverisë -Buxheti	784,328	690,267	648,075	592,128	678,711

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 94,061€. Ky zvogëlim është si rezultat i vendimeve të Qeverisë.

Në vitin 2018, ZRRE ka shpenzuar 94% të buxhetit final ose 648,075€, me një përmirësim prej 7% krahasuar me vitin 2017. Realizimi i buxhetit mbetet në nivel të kënaqshëm përveç në kategorinë e investimeve kapitale dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

¹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	784,328	690,267	648,075	592,128	678,711
Pagat dhe Mëditjet	492,196	457,599	457,599	416,031	442,487
Mallrat dhe Shërbimet	199,332	189,157	167,443	149,256	176,577
Shërbimet komunale	22,000	16,905	14,638	18,196	17,119
Investimet Kapitale	70,800	26,606	8,396	8,645	42,528

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore përfshirë arsyet dhe ndikim që kanë pasur janë si në vijim:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 34,597€ me vendim të Qeverisë si kursime buxhetore. Buxheti për këtë kategori është shpenzuar 100%;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 10,175€. Zvogëlim të buxhetit final kishte edhe tek shërbimet komunale për 5,095€ si rezultat i vendimeve të Qeverisë; dhe
- Buxheti final për investime kapitale në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 44,194€, dhe se në këtë kishte ndikuar ankesa në OSHP nga OE për projektin “Furnizim me pajisje të IT”. Pavarësisht zvogëlimit të buxhetit, gjatë vitit ishin shpenzuar vetëm 31% e buxhetit, për arsye se kërkesa për fillim të procedurave të prokurimit për projektin “Furnizim me Licenca” ishte bërë me vonesë si dhe projekti për “Zhvillim të Softuerit” ishte në ritenderim.

3.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga ZRRE në vitin 2018 ishin në vlerë 1,217,436€. Krahasuar me vitin e kaluar ka një rënie prej 9%. Ato kanë të bëjnë me taksat vjetore të licencimit për gjenerim të ngrohjes, taksa vjetore e licencimit për gjenerim të energjisë elektrike, taksë për energjinë e importuar dhe taksë për shqyrtim të aplikacionit për autorizim për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese. Të hyrat e arkëtuara transferohen në Buxhetin e Kosovës.

Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Pranimet	2017 Pranimet	2016 Pranimet
Të hyrat	-	-	1,217,436	1,412,853	1,573,000
Totali	-	-	1,217,436	1,412,853	1,573,000

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga MAP dhe MF. Kontrollat kyçe që e konfirmojnë saktësinë dhe plotësinë e pagesave janë listat e pagave të nënshkruara nga udhëheqësit e njësisë organizative.

Shpenzimet për paga dhe mëditje gjatë vitit 2018 ishin 457,599€ apo në masën prej 100%. Numri i aprovuar i të punësuarve në ZRRE ishte 33, ndërsa numri aktual i të punësuarve në fund të vitit ishte 31 punonjës.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime dhe shërbime komunale në vitin 2018 ishte 206,062€. Prej tyre ishin shpenzuar 182,081€ apo në masën prej 88%. Ato kanë të bëjnë me furnizime me material harxhues, shërbime, mirëmbajtje dhe shërbime komunale.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.4 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 26,606€, prej tyre ishin shpenzuar vetëm 8,396€ apo në masën prej 31%. Shpenzimet në këtë kategori ishin realizuar për projekte të parapara (teknologji informative).

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.2 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Vlera e pasurisë kapitale mbi 1,000€ e paraqitur PFV ishte 29,388€, ndërsa vlera e pasurive jo kapitale nën 1,000€ ishte 26,783€. Ne kemi rishikuar nëse procesi i regjistrimit dhe mënyra e mbajtjes së evidencës është në pajtueshmëri me kërkesat e Rregullores MF-nr.02/2013, për menaxhimin e pasurisë jo financiare të organizatave buxhetore. Testet tona shpalosën çështjen si në vijim:

Çështja C1² - Dobësi në menaxhimin e pasurive

Gjetja Sipas nenit 6 pika 3 e Rreg. financiare 02/2013- Menaxhimi i pasurisë jo financiare kërkohet që pasuritë jo kapitale dhe stoqet të regjistrohen në sistemin "e-pasuria". ZRRE ende nuk e ka në funksion sistemin e-pasuria. Në mungesë të këtij sistemi, regjistri i pasurisë me vlerë nën 1,000€ është duke u mbajtur në excel. Mos gatishmëria e palëve të përfshira për funksionalizimin e sistemimit e-pasuria ka ndikuar që ky rekomandim të përsëritet prej vitit 2013.

Më tutje, sipas nenit 19 pika 4.3 të kësaj rregulloreje parashihet që, gjendja e dalur nga inventarizimi duhet të krahasohet me gjendjen në regjistrat e pasurisë. Komisioni kishte kryer me kohë inventarizimin, mirëpo edhe këtë vit nuk ishte kryer harmonizimi i pasurive të inventarizuara me regjistrat e pasurive jo financiare.

Rreziku Mbajtja e regjistrat të pasurive jo kapitale në excel, rrezikon identifikimin e ndryshimeve në çdo kohë pa lënë ndonjë gjurmë. Po ashtu, mos harmonizimi i raportit të inventarizimit me regjistrin kontabël, rrit rrezikun që menaxhmenti mos të ketë informata të sakta rreth pasurive. Rrjedhimisht informatat e shpalosura në PFV mund të mos jenë të plota dhe të sakta.

Rekomandimi C1 Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që menaxhimi i pasurisë jo kapitale bëhet konform rregullës përkatëse dhe duke funksionalizuar sistemin e-pasuri. Po ashtu, duhet të bëhet harmonizimi i gjendjes së pasurive në mes regjistrat të pasurisë dhe raportit të inventarizimit të pasurive, në mënyrë që pasuritë të prezantohen drejtë në PFV.

3.3 Të arkëtueshmet

Llogaritë e arkëtueshme sipas të dhënave në PFV ishin 47,879€. Struktura e llogarive të arkëtueshme përbëhet nga obligimet e debitorëve lidhur me taksën vjetore për licencim dhe taksën për energjinë e importuar.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

² Çështja C dhe Rekomandimi C - nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.

3.4 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2018 ishte 9,404€. Këto obligime janë bartur për t'u paguar në vitin 2019. Në përgjithësi ZRRE-ja ka kontrolle të mira në menaxhimin e obligimeve të papaguara.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4 Qeverisja e mirë

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmer veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Qeverisja në ZRRE në fushën e raportimit menaxherial dhe llogaridhënies, si dhe menaxhimin e rrezikut pasqyron një situatë pozitive. Menaxhmenti ka zbatuar pjesën më të madhe të rekomandimeve si dhe ka përgatitur regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat, duke identifikuar të gjitha rreziqet domethënëse që mund të kenë ndikim tek organizata në lidhje me arritjen e objektivave të saj. Sa i përket raportit të vetëvlerësimit ZRRE ka dorëzuar atë në Ministrinë e Financave në afatin e paraparë.

4.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Në bazë të UA Nr.23/2009 për themelimin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm, ZRRE-ja nuk i plotëson kriteret për themelimin e NjAB-së.

Rekomandime

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalesje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se masat e aplikuar janë të mira dhe efektive si dhe mundësojnë një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2018 të ZRRE ka rezultuar në tre rekomandime. ZRRE kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2018, dy rekomandime janë zbatuar dhe një ishte në proces të zbatimit. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2018

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2017	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	Procesi i buxhetit	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj marrjen e veprimeve konkrete në mënyrë që shpenzimet të planifikohen dhe realizohen nga kategoritë ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre sipas standardeve të kontabilitetit të sektorit publik në përputhje me planin kontabël.		I zbatuar
2	Pasuritë	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj mbikëqyrje aktive ndaj personelit që merret me menaxhimin e pasurive përfshirë edhe vazhdimin e përpjekjeve me MAP-in për funksionalizimin e sistemit e-Pasuria. Po ashtu, duhet siguar mbajtja e evidencave të automjeteve dhe harmonizimi i pasurive në mes regjistrave nga inventarizimi me atë të regjistrave të pasurive.	ZRRE ka siguruar mbajtjen e evidencave të automjeteve, mirëpo ende nuk ka funksionalizuar sistemin e-Pasuria si dhe nuk kishte bërë harmonizimin e pasurive në mes regjistrave nga inventarizimi me atë të regjistrave të pasurive	Pjesërisht i zbatuar
3	Menaxhimi i rrezikut	Kryetari i Bordit duhet të siguroj që regjistri i rreziqeve i hartuar në 2018 të ketë një monitorim dhe azhurnim efektiv në baza tremujore për zbatimin e kërkesave në këtë fushë, me qëllim të parandalimit dhe zbutjes së rreziqeve.		I zbatuar
Nr	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2018		
1	Pasuritë	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që menaxhimi i pasurisë jo kapitale bëhet konform rregullës përkatëse dhe duke funksionalizuar sistemin e-pasuri. Po ashtu, duhet të bëhet harmonizimi i gjendjes së pasurive në mes regjistrit të pasurisë dhe raportit të inventarizimit të pasurive, në mënyrë që pasuritë të prezantohen drejtë në PFV.		

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit


157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letërkonfirmimi

	<p>Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo</p> <p>ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI REGULATORNI URED ZA ENERGIJU ENERGY REGULATORY OFFICE</p>	  Nr. <u>161/15</u> Data <u>21-03-17</u>
<p>LETËR E KONFIRMIMIT</p>		
<p>Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2018 dhe për zbatimin e rekomandimeve</p>		
<p>Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit</p>		
<p>Të nderuar,</p>		
<p>Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:</p>		
<ul style="list-style-type: none">• kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018 (në tekstin e mëtejme "Raporti");• pajtohem me të gjeturën dhe rekomandimin dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe• brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimit, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tij.		
<p>z. Arsim Janova</p>  		
<p>u.d. Kryesues i Bordit – Zyra e Rregullatorit për Energji</p>		
<p>Data: 21 mars 2019, Prishtinë,</p>		
<hr/>		
<p>Adresa: Rr. Dervish Rozhaja nr. 12, 10000 Prishtinë, Kosovë Tel: 038 247 615 lok. 101, Fax: 038 247 620, E-mail: info@ero-ks.org, web: www.ero-ks.org</p>		